



Prishtinë, 18 shtator 2008  
Kodi i ZRRE-së: V\_117\_2008

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, duke u bazuar në:**

1. Nenin 15,26 dhe 36.1 pika b) të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
2. Nenin 39 pika b) të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë,
3. Nenin 14/1 pika b) e licencës për furnizim/tregti me energji elektrike Nr. ZRRE\_Li\_19/06 dhënë ndërmarrjes OstElektra GmbH, dhe
4. Kërkesën për përfundim të licencës furnizim/tregti me energji elektrike të datës 29 gusht 2008 të ndërmarrjes OstElektra GmbH, me adresë Keltenring 13, 82041 Oberhaching, Gjermani, **në seancën e mbajtur me datë 18 shtator 2008, nxori këtë:**

**VENDIM**

**I. PËRFUNDON** licenca për furnizim/tregti me energji elektrike Nr. ZRRE\_Li\_19/06, e datës 30 tetor 2006 dhënë ndërmarrjes OstElektra GmbH.

1. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 29 gusht 2008 ka pranuar me anë të postës nga kompania OstElektra GmbH kërkesën për përfundim të licencë Furnizim/Tregti me energji elektrike.
2. Kërkesa e kompanisë OstElektra GmbH për përfundim të licencës arsyetohet me ristrukturimin e kompanisë në fjalë e cila tani ka ndryshuar emrin në S4E Group GmbH ("Solution for Energy Group") dhe është vendosur në adresë të re në Josef-Breher-Weg 3, 82049 Pullach, Gjermani.
3. ZRRE ka vlerësuar kërkesën e kompanisë OstElektra GmbH dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
4. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis versioneve të ndryshme, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
5. Palët e pakënaqura mund të paraqesin ankesë kundër këtij Vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh nga data e nxjerrjes apo data e publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
6. Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordit i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Bordi i ZRRE-së:**

\_\_\_\_\_  
Ali Hamiti, kryesues

\_\_\_\_\_  
Nysret Avdiu, anëtar

\_\_\_\_\_  
Theranda Beqiri, anëtare